

STATUT I SHOQËRISË
“Pura San”
Sh.P.K.

Sot, më 17/ 03/ 2021:

Znj. Frida Pashako, shtetase shqiptare, lindur më 23.08.1983, Tiranë e banuese në Tiranë, mbajtëse e letërnjoftimit me nr. 034374490 dhe nr. Personal I35823066U, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregëtarët dhe Shoqëritë Tregtare” dhe me legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë, miratoi këtë Statut si vijon:

KREU I
THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA

Neni 1

Emri, Forma dhe Themeluesit

- 1.1 Emri dhe emërtimi tregëtar i Shoqërisë është “Pura San” Sh.P.K.
- 1.2 Shoqëria “Pura San” Sh.P.K. është një person juridik privat, e themeluar në bazë të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregëtarët dhe Shoqëritë Tregtare” (më pas referuar si “**Ligji Tregtar**”) në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar (Sh.P.K.).
Shoqëria fiton personalitetin juridik me regjistrimin e saj në regjistrin tregëtar që mbahet nga Qendra Kombëtare e Biznesit (më pas referuar si “**QKB**”) në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara nga Ligji.
- 1.3 Me fitimin e personalitetit juridik, Shoqëria bëhet përgjegjëse kundrejt palëve të treta, për detyrimet dhe dëmet që shkakton gjatë veprimtarisë së saj.
- 1.4 Ortakët e shoqërisë do të janë përgjegjës kundrejt palëve të treta deri në shumën e kontributit të derdhur në kapitalin themeltar të Shoqërisë.

Neni 2

Selia

- 2.1 Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga “Hoxha Tahsin”, nr. 24, Tiranë.
- 2.2 Me vendim të Administratorit, Shoqëria mund të çelë degë dhe/ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë.
- 2.3 Transferimi i selisë në një adresë tjeter: bëhet me vendim të Ortakut të Vetëm, duke u pasqyruar ky ndryshim në regjistrin tregtar.

Neni 3

Objekti

- 3.1 Objekti i shoqërisë do të jetë aktiviteti në ofrimin e shërbimeve ndërhyrëse higjeno-shëndetësore (dezinfektim, deratizim, dezinsektim, DDD); Shërbime pastrimi, higjenizimi, deodorizimi dhe ekspertizë higjeno-sanitare për ambjente të ndryshme; Import-export, prodhim/shitje me shumicë dhe pakicë të produkteve/pajisjeve higjeno-sanitare, produkte



ekologjike, industriale, komerciale, materiale mirëmbajtje, si dhe çdo operacion tregëtar dhe financiar që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj, brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi; Përfaqësimi i shoqërive të huaja; Shitja e produkteve mbrojtese personale dhe te DDD-ve; Shitja e sistemeve te filtrimit dhe higjenizimit te ujit; Sherbime DDD per mjetet tokesore, detare dhe ajrore;

3.2 Objekti i aktivitetit të Shoqërisë mund të ndryshohet dhe/ose zgjerohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Neni 4
Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë e pacaktuar dhe/ose e pakufizuar. Shoqëria mund të mbyllë/pezullohet në cdo kohë me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

KREU II
KAPITALI-KUOTAT

Neni 5
Kapitali themeltar

- 5.1 Kapitali themeltar fillestas i shoqërisë është 100.000,00 (njeqind mijë) Lekë. Kapitali themeltar përbëhet nga 100 (njëqind) kuota me vlerë nominale 1,000,00 (një mijë) Lekë, e cila është paguar dhe zotërohet tërësisht nga ortaku i vetëm themelues.
- 5.2 Ortakët janë përgjegjës kundrejt palëve të treta për humbjet që pëson Shoqëria, deri në shumën e kontributit të tyre në kapitalin themeltar.
- 5.3 Kapitali themeltar mund të zmadhohet ose të zvogëlohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore.

Neni 6
Të drejtat dhe detyrimet e lidhura

- 6.1 Cdo kuotë i jep zotërueshit të drejtën e një vote.
- 6.2 Pronësia mbi kuotat do të regjistrohet në regjistrin e ortakëve që do të mbahet në selinë e Shoqërisë nën Përgjegjësinë e Administratorëve ("Regjistri i Ortakëve").
- 6.3 Regjistri i Ortakëve do të pasqyrojë informacionin e mëposhtëm: a) indentiteti i cdo Ortaku; b) numrin dhe vlerën e kuotave që i përkasin cdo Ortaku; c) datën e fitimit të pronësisë së seçilit Ortak mbi Kuotat; d) adresën dhe selinë e cdo Ortaku; e) detaje për cdo pengapo barrë të vendosur mbi kuotat.

Neni 7
Transferimi i kuotave

- 7.1 Kuotat janë lirisht të transferueshme nëpërmjet trashëgimisë apo ndërmjet Ortakëve ekzistues pa asnjë kufizim.



Neni 8 **Kalimi me Kontratë i Kuotave**

- 8.1 Kontrata e kalimit të kuotës bëhet me shkrim dhe sipas formaliteteve të përcaktuara nga Asambleja e Ortakut të Vetëm. Kjo kontratë do të dërgohet në selinë e shoqërisë.
- 8.2 Ortaku i vetëm mund të refuzojë regjistrimin e kalimit të kuotës në QKB në rast se kjo kuotë nuk është shlyer plotësisht.
- 8.4 Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar për efekt vlefshmërie duhet të bëhet me akt notarial dhe të regjistohet si në librat e shoqërisë ashtu edhe në QKB.

Neni 9 **Zmadhimi i Kapitalit**

- 9.1 Kapitali themeltar mund të zmadhohet, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakut të Vetëm, duke rritur kuotat e ortakëve ekzistues në shumicen e përcaktuar në vendimin përkatës.
- 9.2 Zmadhimi i kapitalit me qellim pranimin e ortakëve të rinj në shoqëri, miratohet nga Asambleja e Përgjithshme me shumicën e kualifikuar të votave të ortakëve.
- 9.3 Kuotat e reja që do të shlyhen si me para në dorë, ashtu edhe në natyrë, do të paguhen në përputhje me Vendimin përkatës për zmadhimin e kapitalit dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare.

Neni 10 **Zvogëlimi i Kapitalit**

- 10.1 Kapitali mund të zvogëlohet, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakut, në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare.

KAPITULLI III **ORGANET E SHOQERISE**

Neni 11 **Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve**

- 11.1 Asambleja e Përgjithshme do të jetë organi më i lartë i Shoqërisë, i cili, veç kompetencave të tjera sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare apo këtij Statuti, merr vendime për çështjet e mëposhtme të Shoqërisë:
- përcaktimi i politikave tregtare;
 - ndryshime të Statutit;
 - ernërimi dhe shkarkimi i Administratorëve;
 - emërimi dhe shkarkimi i likuiduesve dhe i ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - miratimi i skemës së shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat c. dhe d.;
 - miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe i raporteve të ecurisë së veprimtarisë së Shoqërisë;
 - shpérndarjen e fitimeve vjetore;
 - zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit themeltar të Shoqërisë;
 - pjesëtimin dhe anulimin e kuotave;



- k. riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë;
- l. miratimin e rregullave të zbatueshme procedurale të mbledhjeve të saj;
- m. çështje të tjera sipas parashikimeve të bëra prej këtij Statuti.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mblidhet në rastet e përcaktuara nga ligjet e aplikueshme ose nga ky Statut dhe sa herë që është e nevojshme për të mbrojtur interesat e Shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme mblidhet të paktën një herë në vit.

Njoftimi për thirrjen e Asamblesë së Përgjithshme mund të dërgohet me shkrim apo e-mail në adresat e Ortakut ose me postë të regjistruar. Njoftimi do të konsiderohet se i është dorëzuar Shoqërisë me kalimin e ditës së 7-të pas dërgimit.

Njoftimi për thirrjen e Asamblesë duhet të përcaktojë qartë emrin e Shoqërisë, selinë, datën, kohën dhe vandin e mbledhjes, një përshkrim të hollësishëm të procedurës që duhet të ndiqet nga Ortakët per pjesëmarrjen dhe votimin, informacion mbi vandin e menyrën e marrjes së dokumenteve dhe projekt-vendimeve që duhet tu vihen në dispozicion të gjithë Ortakeve, po ashtu edhe rendin e ditës, dhe duhet t'u njoftohet Ortakeve të pakten 7 (shtatë) ditë para mbledhjes. Rendi i ditës i njoftuar si me sipër duhet të përmbajë edhe vendimet e propozuara për çdo çështje. Nëse Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve duhet të vendosë për ndryshime të Statutit, teksti përkatës duhet të njoftohet së bashku me rendin e ditës.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve do të thirret nga Administratorët dhe, kur është e zbatueshme, nga Ortakët.

Ortakët mund të marrin pjesë në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme nëpërmjet mjeteve të ndryshme të komunikimit, përfshirë mjetet e komunikimit elektronik, që garantojnë identifikimin e ortakëve. Mjetet elektronike përfshijnë, por pa u kufizuar në to: a) transmetimin e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme në kohë reale; b) komunikimin e ndërsjellë në kohë reale, i cili u mundëson ortakëve të shprehen për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme nga një vendndodhje tjeter; c) mekanizma, që mundësojnë procesin e votimit, përpara apo gjatë mbajtjes së mbledhjes së asamblesë se përgjithshme, pa qenë nevoja të caktohet një përfaqësues i autorizuar, për të marrë pjesë fizikisht në mbledhje. Përdorimi i mjeteve elektronike, për t'u mundësuar ortakëve të marrin pjesë në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, bëhet me kushtin që të merren masat teknike të nevojshme për të garantuar identifikimin e ortakëve dhe sigurinë e komunikimeve elektronike, deri në atë masë që ky përdorim të jetë proporcional me arritjen e këtyre qëllimeve.

Të gjitha vendimet e Asamblesë duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratorët janë përgjegjës për mbajtjen e një kopjeje të tij.



Neni 12
Organi Administrues / Administratori/ët

Administratorët emërohen dhe shkarkohen nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve.

Administrator i shoqërisë do të jetë:

1. Znj. Klaudia Cenomeri, me mandat emërimi nga 17.03.2021 deri më datë 17.03.2023 dhe me kompetenca të pakufizuara administrimi e përfaqësimi;

Administratori perfaqëson Shoqërinë sipas parashikimeve të ligjit dhe Statutit.

Administratori do të:

- (i) administrojë veprimtarinë tregtare te Shoqërisë duke zbatuar politikat tregtare të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve;
- (ii) përfaqësojë Shoqërinë;
- (iii) kujdeset për mbajtjen e rregullt te librave dhe dokumenteve kontabël;
- (iv) përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë, të cilat ia paraqet Asamblessë së Përgjithshme të Ortakëve për miratim, se bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve;
- (v) krijoje një sistem njoftimi te përshtatshëm për rrethanat qe kërcënojnë ekzistencën e Shoqërisë;
- (vi) kryeje regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave të Shoqërisë, sipas kërkesave te Ligjit Tregtar apo të ligjeve të tjera të zbatueshme;
- (vii) raportojë përpara Asamblesë se Përgjithshme te Ortakeve mbi zbatimin e politikave tregtare si dhe për përfundimin e transaksioneve me rëndësi të veçantë për performancën e Shoqërisë;
- (viii) përfaqësimin e shoqërisë në gjykime;
- (ix) kryeje detyra të tjera, te përcaktuara në Ligjin Tregtar dhe në këtë Statut;
- (x) thërrasë mbledhjen e Asamblesë se Ortakeve sa herë që kërkohet sipas Ligjit apo këtij Statuti.

Administratori mund të autorizojë persona të tjerë për të vepruar në emër dhe për llogarinë e tij, duke specifikuar / përcaktuar kategorinë e akteve dhe veprimeve qe përfaqësuesi mund të kryejë.

Neni 13
Kontrolli i Shoqërisë

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mund të emërojë një ose disa eksperte kontabël të autorizuar për kontrollin e llogarive të Shoqërisë.

KAPITULLI IV
VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE, FITIMET DHE REZERVAT LIGJORE

Neni 14
Viti Financiar

Viti financiar ka një kohëzgjatje prej 12 (dymbëdhjetë) muajsh e cila fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor të cdo viti.



Neni 15
Rezerva Ligjore

Shoqëria do të kalojë në fondin rezerve të detyrueshëm të paktën 5% (pesë përqind) të fitimit vjetor neto derisa kjo rezervë të arrijë vlerën e barabartë me 10 përqind të kapitalit themeltar.

Neni 16
Dividendet

Pas miratimit të bilancit vjetor dhe përcaktimit të shumës që do të ndahet, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve përcakton shumën e fitimeve që do t'i shpërndahet secilit prej Ortakëve si dividend, në përpjesëtim me pjesën përkatëse në kapitalin themeltar, në këtë rast ortakut të vetëm.

KAPITULLI V
PRISHJA - LIKUIDIMI

Neni 17
Prishja e Shoqërisë

Shoqëria mund të prishet për shkaqet e parashikuara në dispozitat ligjore dhe parashikimeve të këtij statuti.

Neni 18
Likuidimi

Me përashtim të rastit të fillimit të një procedure falimentimi, prishja e Shoqërisë shoqërohet me fillimin e procedurës së likuidimit.

Neni 19
Dispozita Përfundimtare

Për të gjitha cështjet që nuk janë parashikuar në këtë Statut, do të zbatohen parashikimet e Ligjit Tregtar.

Ky Statut nënshkruhet rregullisht në 3 (tre) kopje origjinale në gjuhën Shqipe.
Lexua, pranuar dhe nënshkruar nga Ortaku themelues i shoqërisë.

Ortaku themelues
Frida Pashako


